

## Njoftim

Në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e Garancive të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

Ftohen të gjitha palët e interesuara të shprehin komentet dhe rekomandimet e tyre me shkrim, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga dita parë e publikimit të këtij njoftimi pranë zyrave të ERE-s në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, 1023, Tiranë; ose në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al).

“Rregullorja për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e Garancive të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, gjendet e publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në adresën [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al), në seksionin Konsultime.